

**Akti i Themelimit
të “Kolegji Heimerer” Sh.P.K.**

Më dt. 01. 12. 2019 në Tiranë, në pajtim me ligjin Nr. 9901 “për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe ligjin nr. 9723 për “Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, z. Petrit Beqiri dhe z. Adrian Heimerer, vendosin që të themelojnë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar “Kolegji Heimerer” (në vazhdim: shoqëria), sipas termave në vijim:

Neni 1

Themeluesit, forma dhe emri i shoqërisë

1. Themelues dhe njëherësh aksionarë të shoqërisë janë:

1.1.

Emri dhe Mbiemri: Petrit (Halil) Beqiri i lindur më 27.04.1972;

Shtetësia: Shtetas i Republikës së Kosovës;

Numri personal: 1004408825 ;

Vendbanimi: Pemishtë, 41000 Skënderaj;

E-Mail: petrit@gmx.de;

Tel. +38345820820.

1.2.

Emri dhe Mbiemri: Adrian (Friedrich) Heimerer i lindur më 16.03.1992;

Shtetësia: Shtetas i Republikës Federale të Gjermanisë;

Numri personal: LCGR4XW6Z;

Vendbanimi: Sonnenstr nr. 2, 86899 Landsberg, Gjermani;

E-Mail: adrian@heimerer.de ;

Tel.: +49 178 8928812.

2. Shoqëria themelohet si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

3. Emri zyrtar i shoqërisë është “Kolegji Heimerer” SH.P.K.

Neni 2

Selia dhe degët e shoqërisë

1. Selia shoqërisë ndodhet në adresën Njësia bashkiake nr.5, Bulevardi Bajram Curri, Pallati Agimi, sh. nr.4, ap. nr.62, 1001 Tiranë, Republika e Shqipërisë.



2. Shoqëria mund të hapë degë dhe zyrë përfaqësimi në qytete/regjione tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë territorit të saj, gjithnjë duke respektuar dispozitat ligjore përkatëse të legjisllacionit shqiptar.

Neni 3

Kapitali themeltar dhe zotërimet e aksionarëve

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1000 Lek dhe i përbërë nga 2 kuota.
2. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - 2.1. Petrit Beqiri: Zotërues 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 600 (gjashtëqind) Lekë që përbën 60 % të kapitalit themeltar.
 - 2.2. Adrian Heimerer: Zotërues 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 400 (katërqind) që përbën 40 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Kapitali fillestar është i papaguar dhe do të paguhet sapo të bëhet regjistrimi i shoqërisë dhe hapja e llogarisë bankare në emër të shoqërisë.

Neni 4

Objekti i aktiviteteve së shoqërisë

1. Shoqëria do të ushtroj veprimtari nga fushat në vijim: arsim fillor, arsim i përgjithshëm i mesëm, publikimi i librave, publikimi i revistave dhe periodikëve, arsim i lartë, arsim i mesëm teknik dhe profesional, aktivitete të shëndetit të njeriut, aktivitete të mjekësisë së përgjithshme, aktivitete të përkujdesjes infermierike në shtëpi, aktivitete në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta, aktivitete të mjekësisë së specializuar, aktivitete të kujdesit social për personat e moshuar dhe për personat me nevoja të veçanta, aktivitete të ueb portaleve, aktivitete të agjencive private për publicitet, aktivitete të këshillimit për biznese dhe këshilla tjera për menaxhim, aktivitete të agjencive të punësimit të përkohshëm, aktivitete tjera ndihmëse për shërbime financiare, aktivitete të mësimin të gjuhëve të huaja, aftësime profesionale në fushën e kujdesit shëndetësor, ndërmjetësim të punësimit në vend dhe jashtë vendit dhe aktivitete të përgatitjes për tregun e punës në vend dhe jashtë saj.
2. Aksionarët themeltar pajtohen që me vendim me shumicë votash mund të heqin apo shtojnë aktivitete të tjera sipas vlerësimit të aksionarëve.

Neni 5


Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria themelohet dhe ushtron aktivitetin e saj për një periudhë të pakufizuar kohore.

Neni 6

Administratori

1. Administrator i shoqërisë caktohet z. Petrit Beqiri, me të dhënat personale si në paragrafin 1.1. të nenit 1 të këtij akti të themelimit.
2. Përmes këtij akti të themelimit, administratori nga paragrafi 1 i këtij neni emërohet për një



periudhë 3 vjeçare, me mundësi të rizgjedhjes.

3. Administratori mund të përfundoj para kohe mandatin e tij në pajtim me dispozitat përkatëse të statutit të shoqërisë.

Neni 7

Dispozitat përfundimtare

1. Çështjet që nuk janë rregulluar me këtë akt të themelimit, rregullohen sipas statutit shoqërisë dhe legjislacionit përkatës për shoqëritë tregtare.
2. Ky Akt i Themelimit të Shoqërisë është hartuar në dy (2) kopje identike, të nënshkruara nga themeluesit. Të gjitha kopjet kanë fuqinë e njëjtë ligjore.

Ortakët themeltar


Petrit Beqiri
PETRIT BEQIRI


Adrian Heimerer
ADRIAN HEIMERER